

# MANIFEST

"Asnjë tranzicion pa punëtorët – Asnjë të ardhme pa drejtësi!"

## MANIFEST I PUNONJËSVE PËR TRANZICIONIN E DREJTË NË SEKTORIN E VESHJEVE DHE KËPUCËVE

Ne, punonjësit e sektorit të veshjeve dhe këpucëve në Shqipëri, shumica gra dhe vajza, kërkojmë që zëri ynë të dëgjohet në procesin e tranzicionit drejt një ekonomie të gjelbër. Me mbi 50,000 punëtorë, ne jemi zemra e këtij sektori dhe kërkojmë një Tranzicion të Drejtë që garanton dinjitet, siguri dhe barazi. Ne do të marrim pjesë aktivisht në proceset e tranzicionit, do të ndajmë përvojën tonë dhe do të mbështesim ndryshimet për një sektor më të fortë dhe më të drejtë.

## KËRKESAT TONA KONKRETE PËR TRANZICIONIN E DREJTË

1. **Paga të drejta jetese** që reflektojnë koston reale të jetesës dhe kontrata të qëndrueshme.
2. **Kushte pune të sigurta** dhe mbrojtje shëndetësore.
3. **Programe trajnime falas** për aftësi të gjelbra dhe teknologji të reja.
4. **Ri-kualifikim** pa pagesë për punëtorët e prekur nga ndryshimet.
5. **Barazi pagash** dhe përfaqësim i grave në vendimmarrje.
6. **Të drejta dhe paga të barabarta për punonjësit emigrantë**, sepse dinjiteti i punës nuk njihet kufij.
7. **Investime në teknologji të pastra** dhe kalim drejt energjive të qëndrueshme.
8. **Forume të rregullta punëtorë-punëdhënës-qeveri** për dialog të vazhdueshëm mbi tranzicionin.



Co-funded by  
the European Union

# THIRRJE PËR VEPRIM

## Drejtuar Qeverisë së Shqipërisë:

- Miratoni një Strategji Kombëtare për Tranzicionin e Drejtë dhe përfshini punonjëset e sektorit në të gjitha forumet e diskutimit.
- Harmonizoni legjislacionin me Konventat Ndërkombëtare të Punës.
- Caktoni burime financiare specifike për mbështetjen e punëtorëve gjatë tranzicionit.

## Drejtuar Bizneseve:

- Respektoni të drejtat tona themelore të punës.
- Investoni në teknologji të pastra që krijojnë vende pune më të mira.
- Zhvilloni plane të qarta për tranzicionin e drejtë dhe përfshini punëtorët në vendim-marrje.

## Drejtuar Institucioneve dhe Kompanive Ndërkombëtare:

- Mbështesni zbatimin e këtij Manifesti dhe monitoroni dhe raportoni respektimin e të drejtave tona.
- Përfshini kushte sociale të qarta në marrëveshjet tregtare.
- Vazhdoni të blini nga Shqipëria, por me kushte të drejta.

***Tranzicioni i vërtetë fillon kur dëgjohet zëri i punëtorëve dhe kur drejtësia sigurohet për të gjithë!***

Për t'u bashkuar dhe mbështetur këtë manifest ose për më shumë informacion:

Qendra "Aleranca Gjinore për Zhvillim" (GADC)

✉ [gadc@gadc.org.al](mailto:gadc@gadc.org.al) | 🌐 [www.gadc.org.al/take-action](http://www.gadc.org.al/take-action)



Gender Alliance for Development Center  
Qendra Aleranca Gjinore për Zhvillim



Co-funded by  
the European Union

# ORGANIZATAT MBËSHTETËSE



LINJA  
E KËSHILLIMIT  
PËR GRA  
DHE VAJZA



Aleanca Kundër  
Diskriminimit LGBT



ARSIS  
Nisma për Ndryshim Shoqëror



IRCRA  
INSTITUTE OF ROMANI CULTURE IN ALBANIA



URBAN  
RESEARCH  
INSTITUTE



Gruaja  
në Zhvillim  
Korçë



Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile  
Civil Society Development Center



"Intelektualet e rinj, Shprese"



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri



ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT



Albania Community Assist - ACA  
Asistencë për Komunitetin në Shqipëri



Gender Alliance for Development Center  
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim